



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
DREJTORIA E HARTIMIT TË AKTEVE DHE SHËRBIMEVE JURIDIKE
SEKTORI I HARTIMIT TË AKTEVE DHE PËRPUTHSHMËRISË**

Nr. 3131/2 Prot.

Tiranë, më 27.12.2023

URDHËR

Nr. 122/, datë 27.12.2023

“PËR

**MËNYRËN E MONITORIMIT, RAPORTIMIT DHE ZBATIMIT TË PLANIT
TË INTEGRITETIT TË ZYRËS SË INSPEKTORIT TË LARTË TË
DREJTËSISË 2023-2025”**

Në zbatim të nenit 204, të pikës 1, të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, nenit 43 të Rregullores së Brendshme të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, miratuar me urdhrin nr. 119, datë 12.07.2021, të ndryshuar, si dhe urdhrin nr. 122, datë 06.11.2023 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për miratimin e planit të integritetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë 2023-2025”,

URDHËROJ:

1. Monitorimin, ndjekjen dhe zbatimin e Planit të Integritetit nga Sekretari i Përgjithshëm çdo 6 (gjashtë) mujor. Monitorimi realizohet përmes paraqitjes së kërkesave për informacion, sipas pikës 6 të këtij urdhri, raportimeve të strukturave të përcaktuara në Planin e Integritetit dhe takimeve që zhvillohen për të siguruar ndjekjen dhe zbatimin e aktiviteteve.
2. Plotësimin e informacionit sipas formatit të raportimit të përcaktuar në aneksin nr. 1., bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
3. Zhvillimin e takimeve në kuadër të Planit të Integritetit jo më pak se një herë në 6 (gjashtë) muaj dhe në çdo rast që çmohet e nevojshme, me kërkesë të Sekretarit të Përgjithshëm. Në takim marrin pjesë përfaqësues të strukturave përgjegjëse për raportim ku diskutohen problematikat në përmbushjen e rekomandimeve të Planit të Integritetit dhe rekomandimet me realizim të ulët. Në përfundim të takimit, hartohet përmbledhja e diskutimeve dhe nëse ka detyra konkrete për t'u përmbushur. Përmbledhja e diskutimeve u vihet në dispozicion pjesëmarrësve dhe sipas rastit, vendoset afat për realizim kur ka çështje të mëtejshme për ndjekje.

4. Në zbatim të Planit të Integritetit dhe përcaktimeve të këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm:
 - a. shqyrton ecurinë e zbatimit të rekomandimeve sipas afateve të realizimit;
 - b. diskuton dhe përcakton vijimin e punës për çdo rekomandim të planit;
 - ç. ndjek publikimin e raporteve gjashtë mujore në faqen zyrtare;
 - d. sipas rastit i rekomandon Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nevojën e ndërmarrjes së masave në funksion të arritjes së rekomandimeve të parashikuara Planit të Integritetit.
5. Në përmbushje të përcaktimeve sipas këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, cakton emrin nominal të specialistit të Sektorit të Analizës dhe Studimeve, për të asistuar në grumbullimin, përpunimin dhe hartimin e raportit të monitorimit.
6. Në funksion të raportimit zbatimit të këtij urdhri, specialisti ka këto detyra:
 - a. brenda datës 5 të çdo 6 (gjashtë) mujori pasardhës, kërkon informacion pranë titullarëve të strukturave përgjegjëse ose personave të caktuar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë për të përcjellë informacionin, sipas objektivave të përcaktuara në Planin e Integritetit;
 - b. koordinon, mbledh dhe përpunon informacionin e dërguar nga të gjitha strukturat e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
 - c. brenda datës 28 të çdo 6 (gjashtë) mujori, harton dhe vendos në dispozicion të Sekretarit të Përgjithshëm raportin e monitorimit, si dhe nivelin e përmbushjes së rekomandimeve. Niveli i përmbushjes së secilit rekomandim llogaritet në përqindje, duke pjesëtuar totalin e përqindjes (100%) me numrin e nën masave të zhvilluara për secilin rekomandim;
 - ç. parashtron problematikat e hasura gjatë procesit të raportimit;
 - d. ndjek dhe zbaton rekomandimet e dhëna nga Sekretari i Përgjithshëm.
7. Raporti i monitorimit t'i përcillet Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, brenda 5 ditëve nga takimi i zhvilluar sipas pikës 3 të këtij urdhri dhe publikohet në faqen zyrtare të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
8. Ngarkohen të gjitha strukturat e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me zbatimin e këtij urdhri.
9. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin dhe publikimin e këtij urdhri, në faqen zyrtare të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Artur Metani

